VENDIM
Nr.1075, datë 29.12.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut të parë të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të repartit ushtarak nr.1010, Shkodër, si institucion varësie, si autoritete kontraktore, për të vijuar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit me objekt "Blerje ushqimesh që prishen".

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha